
ETLEVA HAXHIA

DREJTORE E QENDRES SE BOTIMEVE ZYRTARE

{ E-mail: etlevahaxhia@gmail.com }

Znj. Etleva HAXHIA është diplomuar **Ekonomiste** në Fakultetin e Ekonomisë
Universiteti i Tiranës / **Juriste** në Fakultetin e Shkencave Politike e Juridike, Dega Drejtësi.

Më pas, ka marrë Titullin “Avokat” nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë. Zotëron shumë mirë
Gjuhën Angleze, me Dëshmi të lëshuar nga Fakulteti i Gjuhëve të Huaja, Universiteti i Tiranës.

Ka qenë pjesëmarrëse në trajnime të vazhdueshme kualifikuese si psh ;

- trajnimin me temë “Rritja e Efikasitetit në Administrimin e Drejtësisë”
Hagë, Hollandë
- në Kursin e Trajnimit të Detyrueshëm për nëpunësit civil të ILDKPKI-së “Prezantimi me
Administratën Publike”, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike
- trajnimin me temë “Mbrojtja e të dhënave personale në Shqipëri për përafrimin me
Standardet Euopiane”, financiar nga Bashkimi European dhe shumë trajnime të tjera.

Znj. HAXHIA vjen me një eksperiencë të gjatë në sektorë të rëndësishëm të administratës
shtetërore . Së fundmi , ajo kryen funksionet e saj si Drejtoreshë në Qendrën e Botimeve Zyrtare,
Ministria e Drejtësisë.

Ka spikatur me eksperiencën e saj si Këshilltare në Komisionin Qëndror të Zgjedhjeve.

Ka dhënë kontributin e saj si Drejtore e Drejtorisë së Administratës Gjyqësore në Gjykatën e
Lartë, Tiranë dhe Drejtore në Drejtorinë e Kontrollit të Konfliktit të Interesit, Inspektoriati i
Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive

Ka shërbyer gjithashtu si Kryetare e Zyrës së Prokurimit, Shoqëria e Sigurimeve “INSIG” sh.a
dhe Specialiste në Departamentin e Jetës, Shoqëria e Sigurimeve “INSIG / Juriste Departamenti
Juridik, Shoqëria e Sigurimeve “INSIG” .

Ka shërbyer gjithashtu, si shefe e sektorit të Statistikës , në Ministrinë e Drejtësisë e të tjera.
